

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "Shtypshkronja Guttenberg" Sh.p.k.

Sot, me datë 18/12/2018,

Zj. Arlinda Dudaj, shtetase shqiptare, atësia Agim, lindur më 07/10/1977, në Tiranë, banuese në Rruga "Abdyl Frashëri", Pall.6/1, Ap.5, Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. 024407934, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Shtypshkronja Guttenberg" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Shtypshkronja Guttenberg" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr.6, Rruga "Hamdi Pepa" nr.40, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Veprimtari në fushën e shtypshkrimeve dhe botimeve. Shtypshkronjë, Shtëpi botuese. Projektim, shtypshkrime, botime për libra, revista dhe reklama, fletëpalosje etj. Printime dixhitale të gjitha llojet për libra, revista dhe reklama. Import, eksport i makinerive të ndryshme të të gjitha llojeve për shtypshkrime dhe printime dixhitale për reklama, libra dhe revista. Projektim, shtypshkrime dhe stampime të produkteve që përmbajnë element sigurie. Shtypshkrime për të gjitha llojet. Botime dhe shtypshkrime, import-eksport, tregtimin e të gjitha paisjeve dhe materialeve tipografike dhe shtypshkronje. Konceptimi, organizimi dhe menaxhimi i reklamave të fushatave, eventeve, fushatave të marketingut,

marrëdhënieve me publikun, spoteve publicitare, në fushën e desing, publikimeve, reklamave dhe promocionit. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme të lejuar nga ligji për relizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1.000.000 (një milion) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Arlinda Dudaj**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë dhe 1.000.000 (një milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Zj. Arlinda Dudaj**, shtetase shqiptare, atësia Agim, lindur më 07/10/1977, në Tiranë, banuese në Rruga "Abdyl Frashëri", Pall.6/1, Ap.5, Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. 024407934, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratoren, Zj. Arlinda Dudaj**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

ARLINDA DUDAJ

Arlinda Dudaj

A stylized handwritten signature mark consisting of a large, bold letter 'A' with a vertical line through it, enclosed in a triangular shape.